



Ref.: 1515/24 Datë: 05/08/2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 126 të mbajtur më datë 22.07.2024 Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohen programi e studimit të Kolegjit Biznesi për periudhën tre (3) vjeçare, (1 tetor 2024 - 30 shtator 2027):
 1. *Menaxhment dhe Financa MA 120 ECTS, me kuotën maksimumi 100 studentë për vit akademik;*
 2. *Menaxhimi i Emergjencave MA 120 ECTS, me kuotën maksimumi 67 studentë për vit akademik;*
- II. Numri i studentëve si në paragrafin I, zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- III. Obligohet Kolegji Biznesi që deri më datë 15.11.2024 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- IV. Obligohet Kolegji Biznesi të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Ndryshimi i bartësve bëhet vetëm me vendim nga KShC.
- V. Institucioni i Arsimit të Lartë si në paragrafin I mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Kolegji Biznesi brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për riakreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Menaxhment dhe Financa MA 120 ECTS R;</i>	Betim Spahiu Ariana Xhemajli Nexhmije Kabashi
2.	<i>Menaxhimi i Emergjencave MA 120 ECTS R;</i>	Rushan Ceka Iliriana Demaj Edona Kabashi Kastrati

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjin Biznesi në përbërje: Natalie Gurvitsh, Tornike Khoshtaria dhe Horia Onita.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

- Për programin e studimit; *Menaxhment dhe Financa, MA 120 ECTS***, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Natalie Gurvitsh, Tornike Khoshtaria dhe Horia Onita student, është organizuar më 04.06.2024 ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht dy (2), Substancialisht pesë (5) fusha të standardeve.
- Për programin e studimit; *Menaxhimi i Emergjencave, MA 120 ECTS***, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Tornike Khoshtaria, Natalie Gurvitsh, dhe Horia Onita student, është organizuar më 04.06.2024 ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht tre (3), Substancialisht katër (4) fusha të standardeve.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 126-të, të mbajtur më datë 22.07.2024, ka shqyrtuar dokumentacionin e Kolegjit Biznesi dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave si dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit Biznesi;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.

Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë